



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. _____ Prot

Shkodër, më ____/____2021

Lënda: Informacion

Znj. _____

1. Cili është funksioni i Bashkisë Shkodër në kuadrin e menaxhimit dhe mirëmbajtjes së argjinaturës së lumit Buna në segmentin Pentar-Luarëz ?

Në vijim të zbatimit të ligjit 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, i cili përcakton funksionet, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e njësisve të vetëqeverisjes vendore, dhe konkretisht në nenin 27 të këtij ligji ku përcaktohen funksionet e Bashkisë në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural, VKM nr.1109, datë 30.12.2015 dhe udhëzuesit të AZRT nr.540/1, datë 31.12.2015; nga ana e Bashkisë Shkodër (Urdhër i Kryetarit të Bashkisë me nr.3, datë 12.01.2016); është marrë në dorëzim inventari i ujitjes dhe kullimit, i transferuar. Në këtë inventar përfshihen të gjitha kanalet e II dhe të III kullues në territorin administrativ të Bashkisë Shkodër.

Përsa i përket kanaleve të para kulluese (kolektorët), hidrovoret, rezervuarët me digat e tyre si dhe argjinaturat ato mbeten kopetencë e qeverisjes qendrore dhe konkretisht Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Lezhe.

Bashkia Shkodër në zbatim të ligjit 24/2017, për “ Administrimin e Ujitjes dhe Kullimit”, neni 15, ka pastruar dhe mirëmbajtur infrastrukturën e kullimit (në inventarin e saj).

Në të gjitha rastet kur nga ana e specialistëve pranë Bashkisë Shkodër **janë vërejtur dëmtime apo problematika në infrastukturën (argjinaturë), e cila është në inventarin e Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Lezhë, i ka referuar këto shkresërisht këtij**

institucioni përgjegjës,(sipas ligjit 24/2017, për “ Administrimin e Ujitjes dhe Kullimit”,**neni 13, pika 2, germa ç**) (“ mbikëqyr sigurinë e digave të rezervuarëve për ujitje dhe veprave të mbrojtjes nga përmbytja dhe, kur është e nevojshme, kryen ndërhyrje emergjente të mirëmbajtjes apo rehabilitimit për garantimin e sigurisë së tyre”),dhe **pikës 2)**“ Drejtoria e ujitjes dhe e kullimit, me urdhër të ministrit, ndërmerr, në raste të veçanta, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e përkohshme të infrastrukturës së ujitjes, kullimit dhe veprave të mbrojtjes nga përmbytja të transferuara bashkisë, në raste të tilla si cenim i sigurisë së digave dhe përmbytje”.)

2. Kur është bërë pastrimi i kësaj argjinature për herë të fundit ?

Përsa i përket segmentit të argjinaturës Pentar-Luarëz, në inventarin e Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Lezhë, **nga informacionet që disponojmë**, në periudhën Maj-Dhjetor 2019 është ndërhyrë nga kjo Drejtori në rehabilitimin e plote të këtij segmenti.

Gjatësia e rehabilituar e këtij segmenti arrin në rreth 6 600 ml.

(pastrimi dhe mirëmbajtja e këtij segmenti, është bërë deri në muajin Dhjetor 2020, e përfshirë mbrenda garancisë të firmës kontaktuese).

Për informacion më të detajuar për vlerën, dhe punimet Ju orientojmë të drejtoheni pranë Drejtorisë Rajonale të Ujitjes dhe Kullimit, Lezhë.

K R Y E T A R

Voltana ADEMI

